



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.31.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMISIONIT TË PAVARUR
PËR MINIERA DHE MINERALE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi, i mbështetur nga, Astrit Bllaca (Udhëheqës Ekipi), dhe Arta Kryeziu

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	10
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	20
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	23

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Kryetarin e bordit dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 04 nëntor 2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për pasqyrat vjetore financiare të theksuara në memon e planifikimit të auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Komisionit të pavarur për Miniera dhe Minerale (duke përfshirë ekzekutimin e buxhetit dhe auditimin e brendshëm).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm është:

Pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (**ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar**).

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Progresi i bërë lidhur me adresimin e rekomandimeve, nuk është i mjaftueshëm në raport me kërkesat e auditimit. Kjo paraqet nevojën për veprime shtesë për të adresuar të gjitha çështjet e ngritura nga auditimi.

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të buxhetit marrë si tërësi janë relativisht të mira. Megjithëse sipas kategorive ekonomike të kategoria e investimeve kapitale dhe kategoria e mallrave dhe shërbimeve, kërkohet një zhvillim i mëtejme i procesit buxhetor.

Më tutje, kontrollet mbi menaxhimin e të hyrave dhe të arkëtueshmeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Ato në raste të caktuara ishin shmangur nga legjislacioni në fuqi. Ndërsa nga aspekti i rëndësisë më të ulët, kontrolle shtesë nevojiten edhe të menaxhimi i shpenzimeve dhe pasuria.

Rekomandimet tona kryesore janë si në vijim:

Kryetari i bordit duhet të sigurojë se:

- Plani i veprimit, i rishikuar, ka përcaktuar saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme;
- Përgatitja e buxhetit paraprihet nga një proces rigoroz i vlerësimit që pasqyron të gjitha informatat relevante përfshirë realizimet e vitit paraprak dhe ndryshimet e pritura gjatë vitit. Performanca buxhetore të monitorohet në baza mujore dhe barrierat e identifikuar për nivelet e ekzekutimit buxhetor të adresohen me kohë;
- Është vendosur një sistem i përshtatshëm i kontrollit të licencave, prej aplikimit e deri te lëshimi i tyre. Lëshimi i licencave të behët, vetëm pas plotësimit të plotë të dokumentacionit;
- Janë aplikuar kontrolle shtese në menaxhimin e të hyrave, duke hartuar dhe aprovuar planin vjetor për inspektimin e aktiviteteve minerare dhe monitorimin e tyre në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara; dhe
- Është vendosur një sistem i përshtatshëm i kontrollit, për zbatimin e masave parandaluese në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme dhe inkasimin e parasë publike.

Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do ti adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) të përgatisë pasqyrat vjetore financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallen deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i kishte adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë raporti më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Disa deklaratat kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

KPMM, ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar¹

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale **(ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar)**.

¹ Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200). Për më shumë informacion referohu në shtojcën I.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren e Ministrisë Financave (MF) - Nr 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore (OB-ve);
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 dhe ndryshim plotësimet e tij;
- Kërkesat e rregullores 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike dhe rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare të organizatave buxhetore;
- Nëse PVF-të, janë nënshkruar nga ZKA dhe ZKF; dhe
- Nëse PVF-të janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 05 dhjetor 2013, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrimi

Përveç hartimit të PVF-ve, nga KPMM, kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportin vjetor të punës për vitin 2012;
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit;
- Raportet mbi obligimet e papaguara;
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit; dhe
- Plani i Veprimit për implementimin e rekomandimeve.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto kërkesa.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Në aspektin e adresimit të rekomandimeve, shohim se është bërë një progres nga ana e Menaxhmentit të KPMM-së. Megjithëse, kjo nuk është e mjaftueshme. Andaj Menaxhmenti i KPMM-së, duhet të jetë i gatshëm të marr përgjegjësitë për të gjitha çështjet e ngritura nga auditimi.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 të KPMM-së ka rezultuar në 10 rekomandime kryesore. KPMM, kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2013, gjashtë rekomandime janë adresuar plotësisht, ndërsa katër nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 1 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Edhe përkundër veprimeve të menaxhmentit, një pjesë e rekomandimeve nuk janë adresuar. Rekomandimet e pa adresuara lidhen kryesisht me përmirësimin e kontrolleve në planifikim dhe realizim të buxhetit, menaxhimin e të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme. |
| Rreziku | Dështimi i adresimit të rekomandimeve, rritë rrezikun që dobësitë në funksionimin e kontrolleve të brendshme të vazhdojnë dhe të njëjtat parregullsi të vazhdojnë edhe në të ardhmen. |
| Rekomandimi 1 | Kryetari i bordit duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. |

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe të rezultateve nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky nivel, për shembull, mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komiteti i Auditimit.

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të buxhetit marrë si tërësi janë relativisht të mira. Megjithatë, te kategoria e investimeve kapitale dhe kategoria e mallrave dhe shërbimeve, kërkohet një zhvillim i mëtejme i procesit buxhetor.

Më tutje, kontrollet mbi menaxhimin e të hyrave dhe të arkëtueshmeve kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm. Ato në raste të caktuara ishin shmangur nga legjislacioni në fuqi. Ndërsa nga aspekti i rëndësisë më të ulët, kontrolle shtesë nevojiten edhe të menaxhimi i shpenzimeve dhe pasuria.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për KPMM-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,805,064	1,683,064	1,373,100	1,262,384	1,279,209
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,805,064	1,683,064	1,373,100	1,262,384	0
Të hyrat vetanake	0	0	0	0	1,279,209

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i ulët për 122,000€. Ky reduktim ishte bërë me rishikim të buxhetit.

Në vitin 2013, KPMM ka shpenzuar 82% të buxhet final, i cili ishte një nivel pothuajse i ngjashëm me vitin 2012.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,805,064	1,683,064	1,373,100	1,262,384	1,279,209
Pagat dhe Mëditjet	615,801	615,801	597,866	606,181	599,757
Mallrat dhe Shërbimet	473,763	473,763	341,131	390,594	427,462
Shërbimet komunale	36,000	36,000	21,706	34,816	23,084
Subvencionet dhe Transferet	20,000	20,000	0	0	1,130
Investimet Kapitale	659,500	537,500	412,398	230,793	227,777

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti për paga dhe mëditje në vazhdimësi ishte realizuar në nivel të lartë. Përformancë e mirë vërehet edhe në vitin 2013 me realizim prej 97%;
- Te kategoria e investimeve kapitale, buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte reduktuar për 122,000€. Këtë e kanë shkaktuar pamundësia për të realizuar tri projektet e përfshira në Programin për Investime Publike (PIP). Edhe përkundër reduktimit të buxhetit në këtë kategori, realizimi i buxhetit ishte i ulët në 77%. Megjithatë në raport me vitin 2012 i cili ishte realizuar 61%, ka një përmirësim prej 16%;
- Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në vlerë 473,763€ nuk ndryshon nga buxheti i vitit të kaluar për këtë kategori. Megjithatë realizimi në vazhdimësi ishte në nivel të ulët. Në vitin 2013 realizimi ishte 72%, ose 10% më i ulët se në vitin 2012. Kjo tregon se KPMM nuk ka bërë analiza të mirëfillta rreth trendit të shpenzimeve të vitit të kaluar;
- Te kategoria e shërbimeve komunale janë shpenzuar 21,706€, apo vetëm 60% e buxhetit final. Gjithashtu nëse i krahasojmë me shpenzimet e vitit 2012 vërehet një rënie e dukshme e shpenzimeve. Mirëpo, kjo ishte rezultat i instalimit të sistemit të telefonisë Voip i cili ka reduktuar shpenzimet e telefonisë fikse për afro 50%; dhe
- KPMM me ndarje buxhetore ka pranuar gjithashtu Subvencione në vlerë prej 20,000€. Nuk kishin plan për shpenzimin e tyre.

Tabela 3. Të hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Pranimet	2012 Pranimet	2011 Pranimet
Të hyrat nga licencat	29,270,000	29,270,000	25,255,012	6,413,535	7,840,765

Të hyrat nga administrimi i licencave kishin rritje prej 18,841,477€, i cila ishte rezultat i rritjes së çmimit të rentës së thëngjillit nga 0.26€ në 3€.

Çështja 2 - Ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Ekzekutimit i buxhetit në shumicën e kategorive ishte i ulët e sidomos pjesa e shpenzimeve për mallra dhe shërbimeve dhe investime kapitale. Trendi i vazhdueshëm i ekzekutimit të ulët të buxhetit në kategoritë e lartcekura, tregon se shpenzimet e planifikuara në Sistemin Menaxhues për Hartimin e Buxhetit nuk bazohen në kërkesat reale.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe ekzekutimi i ulët i buxhetit mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi 2** Kryetari bordit duhet të siguroj se përgatitja e buxhetit paraprihet nga një analizë rigoroze që reflekton të gjitha informatat relevante përfshirë realizimet e vitit paraprak dhe ndryshimet e pritura gjatë vitit. Performanca buxhetore të monitorohet në baza mujore dhe barrierat e identifikuar për nivelet e ekzekutimit buxhetor të adresohen me kohë.

Çështja 3 - Planifikimi dhe klasifikim i shpenzimeve - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Blerja e motorit për veturën 'Ford Ranger' në vlerë 2,777€, ishte realizuar gabimisht nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Më tutje kjo vlerë nuk është regjistruar si pasuri në regjistrin kontabël të pasurisë.
- Rreziku** Regjistrimi i shpenzimeve në kategori ekonomike joadekuate, redukton efektivitetin e menaxhimit të buxhetit, saktësinë dhe plotësinë e raportimit financiar.
- Rekomandimi 3** Kryetari i bordit duhet të sigurojë kontrole shtesë në kuadër të sektorit të pagesave, në mënyrë që shpenzimet të klasifikohen dhe regjistrohen në përputhje me planin kontabël të miratuar.

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Përshkrimi

Të hyrat e gjeneruara nga KPMM në vitin 2013 ishin në total 25,255,012 euro. Këto të hyra realizohen nga shfrytëzimi i rentës minerare, gjobave dhe taksave administrative. KPMM, ka një gamë kontrollesh që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave, përfshirë edhe prezantimin e tyre në PVF. Megjithatë, ekziston një nevojë për përmirësimin e proceseve për ta mbështetur pajtueshmërinë e menaxhimit të licencave.

Çështja 4 - Mangësitë gjatë lëshimit të licencave - Prioritet i lartë

E gjetura	<p>Mangësitë gjatë lëshimit të licencave i kemi prezantuar të rastet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none">• Sipas listës së licencave të lëshuara të hulumtimit dhe shfrytëzimit ekzistojnë shumë kompani të cilat kanë aplikuar për licencë, mirëpo KPMM, është vonuar në shqyrtimin dhe aprovimin e tyre. Kjo ka ndikuar që dokumentet e kërkuara si: pëlqimet komunale, pëlqimet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), pëlqimet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), certifikata nga gjykata, si dhe raportet financiare për burime të mjaftueshme) të jenë të vjetërsuara;• Te aplikacioni për licencë, nr.1313 përfshirë edhe gjithë dokumentacionin mbështetës të kërkuar, vërejtëm se KPMM nuk kishte harmonizuar procedurat e brendshme (prej aplikacionit e deri të lëshimi i licencës) më kërkesat ligjore. Kjo ka ndikuar në tejkalimin e afateve të shkurtuara me ndryshimin e plotësimin e ligjit për miniera dhe minerale për licencimin e kompanive; dhe• Bordi i KPMM-së ka aprovuar vendimin për aplikacionin e bashkimit të licencave. Në dy raste në cilat janë bashkuar licencat (licenca e lëshuar me nr. 1333 e vazhduar deri me 21.05.2024 dhe licenca nr. 1330 e vazhduar deri me 20.11.2015). Në të dyja rastet në momentin e lëshimit të licencës njëra nga licencat kishte skaduar dhe është dashur të zbatohen procedurat sipas kërkesave ligjore.
Rreziku	<p>Mos respektimi i kërkesave të brendshme gjatë lëshimit të licencave mund të rezultojë në dhënien e licencës operatorit të papërshtatshëm si dhe të ndikoj në efikasitetin e institucionit në arritjen objektivave të caktuara.</p>
Rekomandimi 4	<p>Kryetari i bordit duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi të përshtatshëm të kontrollit prej aplikimit e deri te lëshimi i licencës. Lëshimi i licencave të behët, vetëm pas plotësimit të plotë të dokumentacionit.</p>

Çështja 5 - Mungesa e planit dhe komisionit për inspektim - Prioritet i lartë

E gjetura Në bazë të udhëzimit administrativ nr. 003/KPMM/09, kryeinspektori dhe udhëheqësit e departamenteve janë të obliguar që për çdo vit të formojnë komisionin dhe të hartojnë planin për inspektimin e aktiviteteve minerare. Plani duhet të aprovohet nga Drejtori. Komisioni duhet të përbehet nga Inspektorati, Gjeologjia, Gjeodezia, financat dhe makineria e elektrika sipas nevojës.

Ne vërejtëm se asnjëra nga kërkesat e lartcekura nuk ishin respektuar nga KPMM-ja.

Rreziku Mungesa e planit vjetor dhe formimit të komisionit për inspektim të rregullt të kompanive mund të rezultojë në mos arritjen e një sistemi mbikëqyrës efektiv.

Rekomandimi 5 Kryetari i bordit duhet të siguroj që është formuar Komisioni dhe të aprovojë planin vjetor për inspektimin e aktiviteteve minerare dhe monitorimin e tyre .

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Në këtë fushë të shpenzimeve ne kemi përfshirë të gjitha prokurimet që ndërlidhen me investimet kapitale si dhe ato për mallra dhe shërbime. Ekzaminimet tona audituese kanë përfshirë tërë procesin e prokurimit, duke filluar nga inicimi i aktiviteteve të prokurimit e deri në menaxhimin dhe realizimin e kontratave.

Gjatë vitit 2013, KPMM përmes prokurimit ka realizuar 39 kontrata. Ne, kemi testuar tetë kontrata në vlerë prej 421,255€. Po ashtu, kemi testuar 27 pagesa në vlerë prej 306,927€ , që kanë kaluar përmes procedurave të prokurimit.

Çështja 6 - Servisimi i automjetit me procedurë jo adekuate - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Në pagesën e testuar për riparimin e automjetit i dëmtuar si pasojë e sistemit elektronik (GPS), ishin ndërruar pjesë të cilat nuk ishin të përfshira në kontratë. Në mungesë të kësaj operatori ekonomik (OE) kishte faturuar KPMM për (punë dore) në vlerë prej 1,784€.
- Rreziku** Mos ndjekja e procedurave të duhura dhe udhëzuesve përkatës ka rezultuar me pagesë të parregullte, e cila mund të rezultojë me humbje financiare për KPMM-në.
- Rekomandimi 6** Kryetari bordit duhet të iniciojë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë respektuar në të gjitha rastet e prokurimit, si dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se dobësitë e identifikuar janë adresuar.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrimi

Në kategorinë e shpenzimeve tjera ku nuk nevojiten procedura të prokurimit, ne testuam pesë pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë 11,022€. Në këtë kategori të shpenzimeve është vendosur sistem funksional i kontrollit. Ky është viti i dytë që testimet tona nuk kanë rezultuar me ndonjë mangësi.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

KPMM, për vitin 2013 për kategorinë paga dhe mëditje kishte shpenzuar 597,866€ apo 97% e buxhetit final. Ne kemi testuar transaksionet për paga, procesin e rekrutimit, pensionimin dhe kemi krahasuar pagat e aprovuara me pagesat e kryera.

KPMM ka kuptuar kërkesat për funksionim të kontrolleve të forta në fushën e shpenzimeve për paga dhe mëditje dhe ka implementuar të gjitha rekomandimet e dhëna për vitin 2012.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Sipas regjistrit kontabël (SIMFK) lista e pasurive të KPMM-së përmban një vlerë neto prej 1,818,688€, ndërsa pasuria jo-kapitale me vlerë nën 1,000€ është 53,479€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të OB-ve.

Çështja 7 - Menaxhimi i automjeteve Prioritet i mesëm

E gjetura Automjetet në dispozicion të KPMM-së, nuk ishin të pajisura me tabela (targa) zyrtare, për t'u identifikuar se janë pronë e Institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës.

Rreziku Në mungesë të identifikimit të automjeteve me targa zyrtare, krijohen mundësitë për përdorimin më të lehtë të tyre për qëllime private. Kjo mund të pasojë më kosto shtesë, të karburanteve si dhe shpenzimeve tjera rreth riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.

Rekomandimi 7 Kryetari i Bordit duhet të shqyrtoj mundësinë për të pajisur të gjitha automjetet me targa zyrtare në pajtim me kërkesat e UA nr. 31/2012 për regjistrimin e automjeteve.

4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrimi

Borxhet totale të kompanive ndaj KPMM-së, me 31 dhjetor 2013 ishin në vlerë prej 12,858,361€. Me datën e njëjte të vitit të kaluar ato ishin në vlerë prej 11,192,805€. Kjo tregon një rritje të borxheve prej 1,665,556€ apo 15% . Gjatë vitit 2012 dhe 2013 janë proceduar në Gjykatat kompetente 257 vendime në procedurë përmbartimore në vlerë prej 5,181,852€.

Borxhet e vjetra, të cilat janë rritur prej vitit në vit rrezikohen të bëhen të pa mbledhshme. Kjo tregon mos efikasitet të kontrolleve në mbledhjen e borxheve.

Çështja 8 - Menaxhim jo i mirë i të arkëtueshmeve - Prioritet i lartë

E gjetura KPMM, nuk kishte procese dhe kontrolle të duhura në menaxhimin e të arkëtueshmeve. Rastet e tilla janë paraqitur në vijim.

- Nga marrëveshjet për programimin e borxhit, tetë kompani të licencuara nuk kanë zbatuar marrëveshjet. Kjo e gjetur përsëritet që nga viti 2010; dhe
- Me ndryshimin e plotësimin e ligjit për miniera dhe minerale në prill të vitit 2013 është paraparë aplikimi i interesit prej 0.5% për mos shlyerje të borxheve ndaj KPMM-së. KPMM edhe përkundër kësaj nuk ka aplikuar interes për shlyerje të borxheve.

Rreziku Rritja e llogarive të arkëtueshme prej vitit në vit është mjaft shqetësuese. Mos zbatimi i masave parandaluese rezulton në një humbje të drejtpërdrejtë financiare për KPMM-në dhe buxhetin e Kosovës.

Rekomandimi 8 Kryetari i Bordit duhet të sigurojë vendosjen e një sistemi të përshtatshëm të kontrollit, për (zbatimin e masave parandaluese në) menaxhimin e llogarive të arkëtueshme dhe inkasimin e parasë publike.

4.5.3 Trajtimi i borxheve

Përshkrimi

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2013 ishte 11,295€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2014.

Gjatë vitit 2013, KPMM ka dorëzuar raporte të rregullta mujore në pajtim me Udhëzimin Administrativ. Përpos kësaj kontrollet e mira ekzistonin edhe në ekzekutimin e pagesave.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në kuadër të KPMM-së ka përgatitur planin vjetor të auditimit, i cili ka përfshirë fushat me rrezik me të lartë. Bazuar në këtë, kjo njësi ka përgatitur pesë raporte finale, që kanë të bëjnë me procesin e licencimit, raportimin e bartësve të licencës, planifikimin e buxhetit, prokurimit dhe sistemin të hyrave.

Raportet e auditimit ishin cilësore. Ato i kishin mundësuar menaxhmentit të merr siguri lidhur me funksionimin efektiv, ose të kontroleve kryesore përgjatë gjithë procesit të menaxhimit të licencave.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit Të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
3. Rekomandimet nga viti paraprak	Të adresohet çështja e implementimit të marrëveshjeve të dakorduara me operatorët ekonomik për shlyerjen e borxheve të mëhershme dhe atyre aktuale.			Nuk janë marra masat e duhura.
4.2. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Me rastin e hartimit të buxhetit të bëhen analiza të hollësishme, të identifikohen nevojat reale dhe të llogariten kostot sa më të përafërta për projektet kapitale.			Nuk janë marra masat e duhura.
4.4. Të hyrat	Të ndërmer masat konkrete për shqyrtimin e licencave brenda afateteve të parapara me ligj.			Nuk janë marra masat e duhura.
4.4. Të hyrat	Rekomandojmë KPMM-në që të mos lëshoj licencë asnjë operatori ekonomik pa i kryer paraprakisht të gjitha obligimet financiare ndaj KPMM-së.	Po		
4.5.3. Kompensimet (Pagat dhe mëditjet)	Menaxhmenti i KPMM-së duhet të rrit komunikimin me MAP-in që të siguroj që pozitat drejtuese plotësohen me kohë..	Po		

4.5.3. Kompensimet (Pagat dhe mëditjet)	Zyrtarët përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore duhet të instalojnë një sistem të kontrollit të vazhdueshëm për të siguruar që pagat për të punësuarat që janë në pushim të lehonisë të llogariten dhe paguhen konform dispozitave në fuqi.	Po		
4.5.3. Kompensimet (Pagat dhe mëditjet)	Të përmyllet procesi i rekrutimit konform dispozitave ligjore.	Po		
4.6. Pasuritë	Te bëhet inventarizimi i pasurisë në fundvit sipas kërkesës në UA nr 21/2009 me qëllim që të vërtetohet gjendja e gjithë pasurisë në ditën e inventarizimit.	Po		
4.6.2. Trajtimi i të arkëtueshmeve	Menaxhmenti duhet që në mënyrë aktive t'i merr parasysh të gjitha opsionet, përfshirë edhe mjetet ligjore për të siguruar se borxhet do të arkëtohen.			Nuk janë marra masat e duhura.
5. Sistemi i auditimit të brendshëm	Të përgatitet plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve nga NjAB.	Po		